

EMA fillon vlerësimin e përdorimit të vaksinës COVID-19 Comirnaty tek fëmijët e moshës 5 deri në 11 vjeç

Lajme 18/10/2021

EMA ka filluar vlerësimin e një aplikacioni për të zgjeruar përdorimin e vaksinës COVID-19 të BioNTech/Pfizer, Comirnaty, tek fëmijët e moshës 5 deri në 11 vjeç.

Comirnaty është një vaksinë për parandalimin e COVID-19, aktualisht e autorizuar për përdorim tek personat e moshës 12 vjeç e lart. Ai përmban një molekulë të quajtur ARN mesenxher (mRNA) me udhëzime për prodhimin e një proteine, e njohur si proteina spike, e cila është e pranishme natyrshëm në SARS-CoV-2, virusi që shkakton COVID-19. Vaksina funksionon duke përgatitur trupin për t'u mbrojtur kundër SARS-CoV-2.

Komiteti i EMA-s i për produktet medicinale për përdorim human (CHMP) do të rishikojë të dhënat për vaksinën, përfshirë rezultatet nga një studim klinik i vazhdueshëm që përfshin fëmijët e moshës 5 deri në 11 vjeç, në mënyrë që të vendosë nëse do të rekomandojë zgjerimin e përdorimit të tij. Opinioni i CHMP -së më pas do t'i përcillet Komisionit Europian, i cili do të nxjerrë një vendim përfundimtar.

EMA do të komunikojë rezultatet e vlerësimit, që priten brenda disa muajve, përpos nëse nuk nevojiten informacione shtesë.

Comirnaty u autorizua për herë të parë në UE në Dhjetor 2020. Më shumë informacione lidhur me vaksinën janë në dispozicion në faqen e internetit të EMA-s.

Më shumë informata mund të gjenden në vegzën: <https://www.ema.europa.eu/en/news/ema-starts-evaluating-use-covid-19-vaccine-comirnaty-children-aged-5-11>